

Ndryshime negative në kodin e punës

Nga Alfred Bushi

Pasi ka kontribuar publikisht e botërisht në shkatërrimin e sindikalizmit, Edi Rama ka marrë përsipër edhe zhbërjen e Kodit të Punës, saktësisht rë neneve 92 dhe 93, nene të cilat e mbrojnë ligjërisht të drejtën e punëtorëve për pushimer vjetore. Siç thuhet, ndryshimi i nenit 92, që zvogëlon lejen e pushimeve vjetore në 22 ditë pune, paska qenë kërkesë e vetë Rames. Ndërsa neni 93, sipas të cilit leja vjetore nuk mund të jepet më pak se një javë pa ndërprerje (që prapëseprapë ishte pak), ndryshohet duke e copëzuar lejen sipas vullnetit të padronit. Ky propozim na paska ardhur nga deputetë të opozitës së vjetër, të cilët mezi paskan gjetur pak kohë të lirë duke u shkeputur nga lufta e tyre e përgjakshme kundër qeverisë.

Për punetorët dhe ndonjë qe i njuh kushtet e punës nç Shqipëri, këto ndryshime nuk janë aspak risi e as habi. Ka plot raste ku punëtori nuk merr aspak leje vjetore, apo pushime të plota vjetore, e jo më të paguara. Këto vendime janë thjesht sanksionime me ligj të disa akteve të paligjshme shfrytëzimi që bëheshin e bëhen rëndom në vendin e punës. Në vija të pergjithshme, ato nuk janë tjetër veçse vijim i politikave të mirënjohura neoliberales të qeverisë Rama, të cilat synojnë t'i shtyjnë punetoret, tani edhe ligjërisht, drejt një fleksibiliteti më të madh në tregun e punës. Që do të thotë, pasiguri mëbe madhe në vendin e punës, paga të ulëta, pushime të pakëta ose asfare, leje vjetore të copezuara, orë të tejzgjatura pune, frikë dhe izolim

Djegaguri

Në kalendarët e vjetër të shqiptarëve, të cilët i ndanin stinet mbi festa pagane ku Shëngjergji ishte ardhja e pranverës dhe Shënmitri ardhja e dimrit të acartë, stina e verës, ajo e vapës zhuristëse, quhej Djegagur. Një emërtim ky i kobshëm, duke marrë parasysh edhe se stinët e verës, çdo vit, dekadë dhe shekull janë edhe më përvëluese për shkak të rritjes së aktivitetit njerëzor. Këtë emërtim e ka përfshirë në Fjalorin e Gjuhës Shqipe edhe Akademia e Shkencave. Djegagur, pra djegia e gurit, ose gurë që digjen. Por kuptimin më të saktë të kësaj fjale të çuditshme mund ta kuptojnë dhe përjetojnë më së shumti ata që digjen mbi kullat e Tiranës - gurë ciklopikë këta - kacavjerrur në skela, duke lidhur tel ose hedhur beton, për më pak se gjysëm metri katror pagë mujore. Pa ujë, pa pushim, pa të drejta. Pa një qeveri që i mbron. Ata janë punëtorët e ndërtimit. ■

nga organizimi, etj. Pra nëse deri dje punëtorët kishin Kodin e Punës në anën e tyre, sot qeveria Rama po shkallmon edhe atë pak mbrojtje ligjore, duke iu lënë dorë të lirë padronëve në vendin e punës.

Nuk besoj se sot ka shtet perëndimor kapitalist që do të guxonte ta sanksiononte shtypjen e punëtorit me ligj. Në këto vende, pikërisht se kapitaliste, klasa punetore e organizuar do të ngrihej në këmbë, bashkë me ato shtresa, grupime shoqerore, ojf dhe intelektualë, që do bashkoheshin në mbrojtje të punëtorëve. Në vendin tonë, gjysmë kapitalist, gjysmë feudal, gjysmë narkoshtet, gjysmë komik e gjysmë tragjik, fatkeqësisht asgjë nga këto nuk ndodhin, perveç ngritjes së zerit nga Lëvizja Bashkë dhe ndonjë ojf që duhet të justifikojë fondet. Arsyeja është e thjeshtë: armiku i punëtorit nuk ka qenë e nuk është vetem pronari, por bashkë me të edhe shteti, ideologjia sunduese, mediat kryesore. Armiq të punetorit sot jane edhe ojf-të artificiale, sindikatat e korruptuara, intelektualët që e mendojnë veten tëbpavarur e të lirë, kushdo që nuk e ngre zërin të thotë një fjalë kundër padrejtësisë që po i bëhet subjektit e klases sociale që prodhon sot të mirat e shërbimet shoqërore. Një shtet ku shtypja e shfrytëzimi i punëtorit sanksionohen me ligj, që shndërrohet në armik të betuar të punëtorëve, është një shtet që mund të shkojë lehtësisht drejt fashizmit. ■

BANORËT DUKATIT FITOJNË BETEJËN KUNDËR OLIGARKUT SAMIR MANE

Banorët e fshatit të Dukatit në Vlorë protestuan për disa ditë me radhë kundër vjedhjes së burimeve ujore, duke çuar në konfrontime të forta në mbrojtje të burimit të jetesës dhe ekonomisë së tyre fshatare. Pa asnjë njoftim paraprak, pa ligj dhe nëpërmjet allishverisheve, ata janë vendosur përballë faktit të kryer të vjedhjes së ujit kur janë ndeshur me makineritë, tubacionet dhe punëtorët e firmës Gjiguria, oligarkë të vegjël vendas këta në shërbim të oligarkëve të mëdhenj të Tiranës. Të ballafaquar me rezistencën e komunitetit, sipas banorëve, në përforsim të oligarkut Gjiguria kanë ardhur rojet private të resortit luksoz të oligarkut famëkeq Samir Mane, të cilët kanë grushtuar qytetarin Petrit Gjoni. Pas kësaj ngjarjeje, i gjithë komuniteti është hedhur në protestë të hapur, çka çoi në anulimin e këtij plani ogurzi për Dukat. Një fitore e jashtëzakonshme kjo. Megjithatë, 30 fshatra të lumit të Vlorës, rrezikojnë të mbeten me fare pak ujë për të furnizuar milionerët e Green Coast.

FERMERËT E MALIQIT RRIHEN NGA POLICIA

Prej një jave, bujqit dhe fermerët e Maliqit dolën të protestonin në rrugën nacionale për shkak se prodhimi ka mbetur stok, i pashitur. Arsyet sipas tyre janë të shumta. E para, grosistët, ata që kanë monopolin e pikave të grumbullimit, vendosin çmime fare të ulëta për frytet e djersës së derdhur gjatë gjithë vitit, për ti shitur perimet dhe frutat më vonë me çmime disa herë më të shtrenjta në qytetet e mëdha. E dyta, sepse tregtarët e mëdhenj, janë më të interesuar për ta përmbytur tregun vendas me produkte importi, sesa për të mbrojtur prodhuesin tonë. E treta, ngaqë subvencionet e qeverisë shqiptare për bujqit janë qesharake dhe të abuzuara, jo rrallë duke u dhënë arbitrarisht për njerëzit e lidhur me partinë në pushtet. Por ç'është më e turpshmja, edhe pse në rrethana krejt normale të ushtrimit të së drejtës kushtetuese të protestimit, reagimi agresiv i drejtuesve

të Policisë së Shtetit degjeneroi në dhunë, gjoba dhe kërcënime absurde ndaj bujqve të pakënaqur.

ZJARRE, KUDO ZJARRE

Ashtu si çdo verë, edhe këtë vit zjarret kanë përfshirë Shqipërinë nga jugu në veri dhe nga lindja në perëndim. Zjarre në ullishta, zjarre në bjeshkë, zjarre në bregdet, zjarre në katunde, zjarre në pirgjet e mbeturinave në periferitë e qyteteve. Kësisoj, shteti i mijëra veturave luksoze për ministrat dhe drejtorët, i avionëve, i satelitëve në hapësirë, i kullave njëqind katëshe, nuk zotëron as shërbimin më elementar të Zjarrëfikjes. Pajisjet janë të pakta dhe të falura nga jashtë, ndërsa zjarrfikësit paguhen jo më shumë 50.000 lekë të reja, të cilët sëbashku me ushtarët vijojnë të luftojnë zjarret me shqopë dhe lopata, duke rrezikuar seriozisht jetën e tyre. Dhe nuk ka si të ndodhë ndryshe. Shteti ynë me logjikën e shfrytëzimit të shfrenuar është autor i një katastrofe të pashembullt ekologjike dhe në mjaft raste, nuk është çudi që zjarret ti shërbëjnë si atij, ashtu dhe oligarkëve. Për të mbjellë beton mbi natyrën e shkruar.

TË GJITHA RRUGËT TË ÇOJNË TË OLIGARKËT

Aktivistë të Lëvizja BASHKË, shpalosën një banderolë në rrugën e re Thumanë-Kashar në të cilën shkruhej: "Të gjitha rrugët të çojnë të oligarkët". Ashtu si tuneli i Llogarasë që i kushtoi shtetit shqiptarë 190 milion euro të shpie te Green Coast-i i oligarkut Samir Mane, gjithashtu edhe kjo rrugë të shpie te xhepat e oligarkut Bashkim Ulaj. Afro 300 milion euro kushtoi ndërtimi i kësaj rruge dhe sipas kontratës, e privatizuar për 35 vite, kjo rrugë pritet i çojë 1.3 miliard euro xhiro dhe fitime Bashkim Ulajt. Fitime të garantuara edhe nga shteti. Pas plazheve, tokave, shkollave, spitaleve, tani po privatizohen edhe rrugët, duke vënë traun e pagesës në secilën prej tyre. Sakaq, prej dy javësh, banorët e zonës po protestojnë dhe përplasen me policinë për shkak të bllokimit qëllimkeq të rrugës alternative për komunitetin krutan. ■



Supported by Rosa Luxemburg Stiftung Southeast Europe with funds of the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ). This publication or parts of it can be used by others for free as long as they provide a proper reference to the original publication.

The content of the publication is the sole responsibility ICSE and does not necessarily reflect a position of RLS.

Rrugës për në Golgotë

Denis Golgota është një artist mjaft premtues i gjeneratës së re dhe një piktor i jashtëzakonshëm. Dy veprat e mëposhtme, "Kombinati" dhe "Mos shtyj", i kanë dhënë shprehje një simboli urban të Tiranës, autobusit portokalli të Kombinatit, si dhe ankthit të përmjesshëm të klasës punëtore të kryeqytetit, ngjeshjes si sardele në linjat e orës shtatë dhe tetë. ■



Gjashtë poezi rome

Kujtim Paçaku (1959-2018) ishte poet me origjinë rome nga Kosova, si dhe poeti më i madh rom i gjuhës e i letërsisë shqipe. ■

Farkëtari dhe hëna

Që nga agimi e rrahu çekanin mbi
kudhër
Patkonjtë i bëri gati për pazar
Qoftë kjo ditë me bereqet!
Në mbrëmje solli ca bukë në shtëpi
Dhe një grusht sheqerkash
shumëgjyreshe
Në mesnatë
Vjen kënga e vjetër në shoqëri me
hënën
Dhe nga gryka e shishes sikur del
një zë:
"O detharinjë nivar ma te aven!"
"Mëngjeset kurrë mos ardhshin!"

Në zemrat tona

Kaherë e kemi braktisur qiellin e
vendlindjes sonë
Rrugëve të panjohura ia mësyem
Me vete morëm
Vetëm gjuhën, këngët dhe përrallat
tona
Në zemër e ruajtëm gjuhën
Në gjuhë i ruajtëm këngët
Në këngë i ruajtëm përrallat tona

Festa

Si mos të më këndohet e mos të jem
I gëzuar sot
Kur nën krah mbaj bukë
Bukë të nxehta valë
Për të gjithë ata që më presin në shtëpi
Nëna
Gruaja
Dhe shtatë fëmijët
Po nesër?
...Zoti është i madh!

Shikimi i ndaluar

Nëna gjithmonë më porosiste
T'i dëgjoja me të vjetrit e t'i
përsëndesja
"Mirëmëngjesi, zonjë!"
"Mirëmëngjesi, zotëri!"
Babai më këshillonte
Të mos vonohesha rrugës
asnjëherë
"Mos u ndal me të panjohurit!"
"Mos i shiko vajzat dy herë!"
Të gjitha mund të ndaloheshin
ashtu a kështu
Ama, kjo e fundit!

Atë mbrëmje kënduam duke qarë

Ende më kujtohet
Ai dimër i ftohtë; si vdekja
Kur kënga ngrihej në gjuhë
Veshët i mbyllja
Që të mos e dëgjoja këngën e urisë
Këtë këngë pa refren
Dëgjohet melodia
E erës kaotike
Dhe refreni "nënë, duam bukë!"
Atë mbrëmje kënduam duke qarë
Unë
Dhe njëqind violina që i mbaja në
grusht

Jam rom

Po, jam Rom
Unë, ky që qëndron tash para jush
Jam nga stërnipat e Gangut
E bijtë e Lumbardhit
Kurrë nuk isha mjaft i bardhë
Për të bardhët
As tamam i zi për të zinjët
Erdha vetëm t'u fal ca vargje
E të marr ndonjë duartrokite në
këmbim
Kaq më mjafton të ndihem i
lumtur

Viti III / Nr X

E premte, 2 Gusht 2024

Organizohu!

tel: 0692570076
e-mail: organizohu@gmail.com

DETI I PASHPËRBLER I DJERSËS



Ndërkohë që qeveritarët e Shqipërisë Turistike numërojnë entuziastë miliona turistët e huaj në kufi, ata refuzojnë të shikojnë qindra mijëra shërbyesit vendas, ata që ngrenë në këmbë me punën e tyre të pashpërblyer kullat, plazhet, transportin, prodhimin dhe shërbimet për republikën që e dyfishon vetëveten përgjatë stinës së verës.

Me mijëra punëtorë ndërtimi po vazhdojnë të punojnë pa ndërprerje në kantierët e tridhjetë dhe dyzet katëshave të rinj të Tiranës, ndërkaq të gjitha qeveritë e rajonit po ndalojnë punën në orare të caktuara për punëtorët e këtij sektori për shkak të rritjes së temperaturave atmosferike. Punëtorët e fabrikave të tekstilit nuk gëzojnë asnjë rrethanë lehtësuese përballë rrezikut të asfiksionit dhe sëmurjes. Ndërsa me dhjetra mijëra të rinj djersijnë si kamarierë, kuzhinierë, shërbyes në plazhet e jugut e të veriut, pa kontrata, pa paga të kënaqshme, duke punuar gjer në katërmbëdhjetë orë në ditë.

Mbi 4 miliard euro i ka sjellur vitit të kaluar turizmi Shqipërisë, thotë me mburrje kryeministri Edi Rama, por pyetja është se sa nga këto 4 miliard euro shkuan për shqiptarët, për punëtorët, për bujqit, për pensionistët? Ata janë përditë e më të varfër, ndërtues kullash në shtëpi me qera, prodhues këpucësh të ngujuar në shtëpi, shërbëtorë në det por të larë në djersë, pa mundur të marrin asgjë nga pasuria përrallore që prodhojnë. Ata janë deti i pashpërblyer i djersës që një ditë do ta marrë mbrapsht atë çfarë i takon, hakun e punës dhe atdheun e tij të mrekullueshëm. ■